

GJYKATA SUPREME

Rasti nr. : PML-KZZ 147/2017
(P. nr. 98/14 Gjykata themelore e Mitrovicës)
(PAKR nr. 299/16 Gjykata e apelit)

Date: 20 korrik 2017

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro (gjyqtari kryesues dhe raportues), gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova dhe gjyqtarja e Gjykatës supreme të Kosovës Nesrin Lushta, si anëtare të kolegjit, asistuar nga këshilltarja ligjore e EULEX-it Vjollca Kroci-Gerxhaliu, në rastin penal kundër :

O.I., i biri i B.I. dhe O.K., i lindur me ... në ..., ..., me banim në ..., që nga ... është nën masën kufizuese sipas neneve 177 të Kodit të procedurës penale, më tej KPP (Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar) dhe 178 KPP (Paraqitja në stacionin policor) me dokumentet e tij të udhëtimit të marra nga gjykata, dhe

D.D., i biri i D.D. dhe M.S., i lindur me ... në ..., me banim në ...

I akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës PPS 04/2013, të datës 8 gusht 2014, dhe parashtruar në Gjykatën themelore me datën 11 gusht 2014, dhe sa i përket kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ata akuzohen për

(Pika dy e akuzës – 3 akuza)

- 1: Nxitje për të kryer veprën të Vrasjes së rëndë në bashkëkryerje në formë të privimit nga jeta të personit tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje dhe sipas nenit 179 (1.10) në lidhje me nenin 31 dhe 32 të KPK dhe i penalizuar gjithashtu në kohën e

kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafi (2) të KPKSAK në lidhje me nenet 22 dhe 23 të KP të RSFJ;

- 2: Nxitje për të kryer veprën të Vrasjes së rëndë në tentativë në formë të privimit nga jeta të personit tjetër për shkak të motiveve kombëtare, që rezulton në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje , sipas nenit 179 (1.10) dhe nenit 189 (2.1) dhe (5) në lidhje me nenet 28, 31 të KPK, i penalizuar gjithashtu në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30, paragrafi (2) dhe nenit 38 paragrafi (2) të LPKSAK në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KP të KP RSFJ;
- 3: Nxitje për të kryer veprën e Vrasjes së rëndë në tentativë në formë të privimit të jetës të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëveprim me nenet 179 (1.10) në lidhje me nenet 28, 31 dhe 32 të KPK, dhe i penalizuar gjithashtu në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 Paragrafi (2) të LPKSAK në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KP të RSFJ;

shfajësuar me Aktgjykimin e Gjykatës themelore të Mitrovicës P. nr. 98/14, të datës 30 mars 2016, sa i përket pikave të akuzës 2 të gjitha 3 nën-akuza të cekura më lart. Me Aktgjykimin e Gjykatës së apelit të datës 19 dhjetor 2016, duke gjykuar lidhur me ankesat e parashtruara nga prokuroria, Gjykata e apelit (PAKR 299/16), refuzoi ankesën sa i përket pikës 2 të akuzës dhe Aktgjykimi i Gjykatës themelore të Mitrovicës kështu është konfirmuar (akuza 2 dhe po ashtu akuza 3).

Duke vepruar sipas Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë KMLP/I nr. 147/2017 (më tej : Kërkesa) lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së apelit PAKR 299/16, të datës 19 dhjetor 2016, lidhur me akuzën dy, parashtruar nga prokurori i shtetit me datën 28 prill 2017 dhe pranuar nga Gjykata supreme përmes Gjykatës themelore të Mitrovicës me datën 3 maj 2017, dorëzuar avokatëve mbrojtës me datën 2 maj 2017 (N. V. dhe Lj. P. për O.I.; M. B. dhe D. V. për D. D.) dhe, sipas urdhrorit të nënshkruarit (të datës 17 maj 2017, duke aprovuar propozimet e avokateve mbrojtës duke kërkuar që t’iu dorëzohej edhe të pandehurve

sipas nenit 477, paragrafët 2 dhe 4, KPP.), të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës iu janë dorëzuar (D. D. me datën 23 qershor 2017, sipas flete dorëzimit të regjistrit të pranuar në gjykatë me datën 4 korrik, pas disa kërkesave të bëra nga Gjykata supreme);

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe përgjigjeve të avokatit mbrojtës Lj.P. në emër të pandehurit O.I., parashtruar me datën 16 maj 2017 në Gjykatën themelore të Mitrovicës dhe përgjigjeve individuale parashtruar nga i pandehuri Oliver Ivanovic me datën 12 qershor 2017 Krekës për mbrojtjen e ligjshmërisë parashtruar nga prokurori I shtetit ne pijen dy te akuzës të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 299/16 të datës 19 dhjetor 2016; as avokati mbrojtës M. B. e as vetë D.D. nuk parashtruan përgjigje.

Pas këshillimit dhe votimit me datën 20 korrik 2017;

Në pajtim me nenet 418 dhe nenet 432 deri 441 të Kodit të procedurës penale (KPP);

sjell, sipas shumicës, si në vijim:

AKGJYKIM

Gjykata Supreme gjen se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së apelit në rastin PAKR nr. 299/16, të datës 19 dhjetor 2016, është e pranueshme, në pajtim me nenet 418, paragrafi 3, dhe 432, paragrafi 1 dhe nen-paragrafi 1.2, KPP, por është refuzuar si e pabazuar, sipas nenit 437 KPP.

ARSYETIM

Historiku përkatës procedural

1 – Akuza e lartpërmendur fillimisht ishte gjykuar në rastin penal P. nr. 98/2014 të Gjykatës themelore të Mitrovicës. Me Aktgjykimin e sjellë me datën 30 mars 2016 të pandehurit janë gjetur fajtor për veprat penale në fjalë.

2 – Gjatë procedurave të apelit, me datën 19 dhjetor 2016, Gjykata e apelit solli Aktgjykimin PAKR 299/16 dhe konfirmoi shfajësimin e dy të pandehurve O.I. dhe D. D.. Sa i përket akuzës 1 rasti është kthyer ne rigjykim në Gjykatën themelore të Mitrovicës.

3 – Me datën 28 prill 2017, një prokuror i shtetit parashtrori Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit në fjalë të Gjykatës së apelit lidhur me gjykimin e pikës dy sa i përket, shkurtimisht, shkeljes së dispozitës së nenit 384, paragrafi 1.12 lexuar me nenin 370, paragrafët 6 dhe 7 të KPP, sepse Gjykata e Apelit nuk dha ndonjë bazë për secilën pikë individuale të aktgjykimit dhe deklaroi në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë arsyet me të cilat u udhëzua në përcaktimin e pikave të lartpërmendura të ligjit dhe gjithashtu sepse ajo duhet të kishte gjykuar aktgjykimin e shkallës së parë me dyshim të konsiderueshëm në lidhje me saktësinë e përcaktimit faktik dhe prandaj do të duhej ta anulonte verdiktin po ashtu edhe në piken dy të akuzës dhe të urdhëronte një seance gjyqësore po ashtu.

4 – Gjykata themelore e Mitrovicës ia dorëzoi Kërkesën avokatëve mbrojtëse me datën 2 maj 2017 dhe avokatet mbrojtës parashtruan propozimet duke kërkuar që ato ti dorëzohen edhe të pandehurve, gjë që është miratuar me datën 17 maj 2017.

5 – Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte transferuar në Gjykatën supreme me datën 3 maj 2017. Kopja e fletë dërgesës sa i përket dorëzimit të Kërkesës të pandehurit D. D. me datën 23 qershor 2017, është pranuar nga Gjykata supreme me datën 4 korrik 2017.

6 – Në këtë rast, pas hyrjes në fuqi të Ligjit 05 / L-103, nuk është e nevojshme të kërkohet përsëri leje nga KGJK, në bazë të nenit 3, paragrafi 5 të këtij ligji, që kolegji të përbëhet nga shumica e gjyqtarët e EULEX-it dhe një gjyqtar kryesues i EULEX-it sepse Kërkesa e mëhershme (me datën 22/8/2016 PEJ (0107-0001) për të tërë rrjedhën e procedurës ishte miratuar me datën 27 shtator 2016 (KGJK 1123/2016).

Sa i përket vendimit të KGJK, vlen të ceket se nuk i referohet fare për mbrojtjen e ligjshmërisë. Megjithatë, ai fillon duke miratuar kërkesën e EULEX-it (dhe po ashtu përfshinte edhe kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë) dhe në arsyetimin e vendimit nuk ka asgjë sa i përket përjashtimit të kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë).

7- Pas aktgjykimit të Gjykatës së apelit të datës 19 dhjetor 2017, Gjykata Themelore e Mitrovicës po mban një shqyrtim të ri gjyqësor kryesor në lidhje me akuzën 1.

Parashtrësat e palëve

Parashtrësja e prokurorit të shtetit

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së apelit sa i përket pikës së akuzës 2

Prokurori i Shtetit kundërshton gjetjet dhe arsyetimin e Gjykatës së apelit në Aktgjykimin e saj. Sipas prokurorisë, Aktgjykimi i lartpërmendur "shkeli dispozitën e nenit 384 paragrafi 1.12, në lidhje me nenin 370, paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së, sepse nuk dha ndonjë bazë për secilën pikë individuale të aktgjykimit dhe deklaroi në mënyrë të qartë dhe të plotë arsyet me të cilat u udhëzua në përcaktimin e pikave të lartpërmendura të ligjit" dhe të shqyrtohet nga Gjykata Supreme ka dyshime lidhur me saktësinë e përcaktimit faktik dhe prandaj aktgjykimi anulohet dhe një shqyrtim i ri gjyqësor është urdhëruar të mbahet në Gjykatën themelore të Mitrovicës.

Prokuroria pretendon se neni 439 i KPP-së ia mundëson Gjykatës supreme që pas dyshimeve lidhur me saktësinë e gjendjes faktike të anuloj aktgjykimin dhe urdhëroj shqyrtimin e ri gjyqësor, edhe pse në dëm të pandehurit, sepse një normë e tillë (neni 439 KPP-së) paraqet një përjashtim nga neni 432, paragrafi 2, 437 dhe 438, paragrafi 2, KPP-së. Pas kësaj, Prokuroria sqaron meritat në lidhje me pikat 2 deri 5 të propozimit të saj, pasi trajton saktësinë e gjendjes faktike, të arsyetuar ligjërisht (*ex vi* neni 382 paragrafi 1.2 të KPK) mbi nenet 384, paragrafi 12 dhe neni 370 paragrafët 6 dhe 7, neni 361 paragrafi 2 dhe neni 382, paragrafi 2 të KPP-së. Prokurori i shtetit po ashtu pretendon se ka pasur

shkelje të nenit 361 paragrafi 2 të KPP-së pasi që Gjykata e apelit pretendohet se nuk arritur të ofroj bazat për vendimin e saj apo të vlerësoj dëshmitë me ndërgjegje apo t'i adresohet të gjitha argumenteve të paraqitura në ankesën e ankuesit lidhur me të kuptuarit e dëshmive/ provave të paraqitura në gjykim.

Shkurtimisht, Gjykata e apelit dështoi të deklarojë qartë arsyet me të cilat u udhëzua në përcaktimin e pikave të lartpërmendura të ligjit, në paraqitjen e vlerësimit të provave lidhur me atë se përse ishin vërtetuar faktet apo jo apo arsyet me të cilat u pajtuan me shkallën e parë në lidhje me këtë.

Përgjigja e avokatit mbrojtës dhe të pandehurit në akuzën e dytë ndaj kërkesës së prokurorit

Megjithëse ndarazi, të dytë, edhe avokati mbrojtës dhe i pandehuri kanë paraqitur propozime me të njëjtën përmbajtje.

Ata propozojnë Gjykatës supreme të Kosovës të hedh poshtë Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i shtetit si të papranueshme në pajtim me nenin 435 (2) të KPP-së në 2 baza :

- a) Është e ndaluar sipas nenit 433 paragrafi 1 të KPP-së sepse nuk është paraqitur nga personi i autorizuar pasi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm nga Kryeprokurori i shtetit të Republikës së Kosovës dhe jo nga, apo një prokuror special i Kosovës;
- b) Neni 432 I KPPK parasheh në paragrafin 1 llojet e vendimeve gjyqësore kundërt të cilave mund të paraqiten kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në cilat rast lejohet paraqitja e kërkesës për mbrojtje e ligjshmërisë. Rastet kur lejohet ushtrimi i këtij mjeti të jashtëzakonshëm ligjor janë: në rast të shkeljes së ligjit penal; në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale dhe në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të

gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, në pajtim me nenin 432, paragrafi 2, KPP.

Apo, në rast se konsiderohet si e pranueshme, ata i propozojnë Gjykatës supreme ta refuzojnë si të pabazuar, sepse, shkurtimisht, te pandehurit A.L., N.V. dhe I. V.), të cilët pretendohet të jenë nxitur nga O. I. dhe D.D. ishin shfajësuar në formë të prerë në pikën 3 të akuzës.

Kompetencat dhe përbërja e kolegjit

Gjykata supreme e Kosovës është gjykata kompetente për vlerësimin lidhur me mjetet e jashtëzakonshme ligjore, sipas nenit 418 *et seq.* KPP.

Në pajtim me Ligjin për mbi kompetencat, përzgjedhjen e rasteve lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe 05/L-103, rasti konsiderohet si ‘rast në vazhdim’ dhe prandaj është nën juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtareve të EULEX-it, në pajtim me nenin 1, paragrafët 1 dhe 2, dhe 3, paragrafi 5, Ligji 05/L-103 me formulimin e tanishëm të ndryshuar.

Përbërja e kolegjit me shumicën gjyqtarë të EULEX –it, kryesuar nga një gjyqtar i EULEX-it në këtë rast është i bazuar në Vendimin e KGJK nr. KGJK 1123/2016, të datës 27 shtator 2016, të cekur si më lart.

Pranueshmëria e kërkesës

Kërkesa në këtë rast të EULEX-it në vazhdim është paraqitur nga një prokuror i Prokurorisë së shtetit (siç shkruan në vulën e kaltër “Prokurori Shtetit”) dhe, shkurtimisht, Kryeprokurori i shtetit siç ceket në nenin 433 KPP nuk është entitet kompetent për paraqitjen e kërkesës në këtë rast, në pajtim me nenin 12 të Ligjit për prokurorin e shteti 05/L-034, të datës 28 maj 2015, i cili shton nenin 32A ligjit të mëhershëm,

03/L-225 nga shtatori i vitit 2010; sipas paragrafit 1 të nenit 32A të cekur, "gjatë kohëzgjatjes së mandatit të EULEX-it në Kosovë, Kryeprokurori i shtetit nuk mund të marrë juridiksionin për rastet e caktuara tek një prokuror i EULEX-it, pa pëlqimin e Kryeprokurorit të EULEX-it".

Është thënë "shkurtimisht" aq sa mund të thuhet, do të thotë se kodi i ri i procedurës penale është në fuqi që nga 1/1/2013 ... dhe ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme *locus standi* lidhur me paraqitjen e mbrojtjes së ligjshmërisë, si në Procedurën e Përkohshme (Sipas nenit 452 lexuar me nenin 46 *et seq*, mbi kompetencat dhe nenin 151 mbi përkufizimet), por në Kodin e ri të procedurës penale përmendet vetëm Kryeprokurori i shtetit (neni 443 dhe neni 46 mbi kompetencën, referim Ligjit për Prokurorin e shtetit, Kreu IV).

Lejueshmëria e kërkesës

Tani duhet vlerësuar nëse kërkesa është e lejueshme në momentin aktual, pasi shqyrtimi gjyqësor është duke u përsëritur në Gjykatën themelore të Mitrovicës.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë, ose për shkak të shkeljes së procedurave gjyqësore që kanë paraprirë në marrjen e atij vendimi, pasi që procedurat kanë përfunduar në formë të prerë.

Në pajtim me nenin 418, paragrafi 3, KPP, pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre muajsh nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë.

Në këtë pikë dy interpretime do të ishin të mundshme :

A) Mjetet e jashtëzakonshme juridike duhet të përdoren pas një vendim gjyqësor të formës së prerë të procedurës, pavarësisht numrit të akuzave dhe nëse ndonjë ose disa prej tyre nuk i nënshtrohen më shumë ankesës për t'u bërë e formës së prerë.

Edhe në rastin kur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë (

vendimi gjyqësor formës së prerë) mund të paraqitet vetëm pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë –siç është paraqitur në pjesën përfundimtare të paragrafit 1 të nenit 432 të KPP.

Përfundim nga ky kuptim do të ishte në rastin siç është cekur në paragrafin 4 të nenit të njëjtë: një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.

B) Një vendim gjyqësor i formës së prerë ekziston lidhur me një çështje të caktuar gjyqësore, duke përfshirë një akuzë kur në procedurë ekziston më shumë se një, për aq kohë sa të bëhet *res judicata*.

Ky kuptim i fundit është zbatuar nga kolegji.

Kur vijmë tek kjo pjesë, tani është vërtetuar pranueshmëria e kërkesës dhe pretendimet e mbrojtjes si më lart nën **a)** dhe **b)** për papranueshmërinë konsiderohen pa merita, gjithashtu sepse në rastin e **b)** vlen të ceket se prokuroria e paraqiti kërkesën e saj gjithashtu duke u bazuar në pretendimin lidhur me shkeljen esenciale të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 1.12, KPP.

Prokuroria shtjellon në argumente të ndryshme,

Bazat për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur në nenin 432, paragrafët 1 dhe 4, dhe neni 433, paragrafi 4, KPP.

Në pajtim me nenin 432, paragrafi 2, KPP, është e qartë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, siç thuhet qartazi në nenin 437 KPP se në rast të tillë Gjykata supreme e refuzon atë, me një aktgjykim.

Ndërsa neni 438 KPP, paragrafi 2, deklaron se nëse Gjykata supreme gjen se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitur në dëm të pandehurit është e bazuar mirë, ajo vetëm do të përcaktojë se është shkelur ligji.

Megjithatë, prokuroria pohon se neni 439 KPP – ku thuhet se “me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara në vendimin kundër të cilit është paraqitur kërkesë (...) Gjykata supreme e Kosovës me aktgjykim e saj (...) anulon vendimin dhe urdhëron mbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor” – paraqet përjashtim nga neni 437 KPP (dhe logjikisht nga neni 432, paragrafi 2, KPP) dhe nga neni 438, paragrafi 2, KPP ose, siç deklaroi prokuroria, neni 439 KPP është një “përjashtim nga të gjitha normat të cilat e rregullojnë procesin e shqyrtimit të mbrojtjes së ligjshmërisë ", duke mundësuar që Gjykata supreme të gjykojë lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ta kthejë çështjen për rigjykim nëse" mbrojtja e ligjshmërisë paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike një gabimi apo nëse mbrojtja e ligjshmërisë është paraqitur vetëm në dëm të të pandehurit.

Gjykata supreme, në këtë rast, ngjashëm me të tjerët ku diskutohet e njëjta çështje (p.sh. Pml. Kzz 216/2016) nuk sheh ndonjë arsye për të devijuar nga kuptimi i saj i mëparshëm.

Kolegji është i mendimit se “në pajtim me nenin 439, Gjykata supreme mund të anulojë verdiktin dhe ta kthejë rastin në rigjykim nëse ka mundësi për një verdikt më të favorshëm për të akuzuarin që ti kthehet procedurave të reja. Neni 439 duhet lexuar me sipas nenit 440, I cili në paragrafin 4 parasheh se nëse aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, ‘gjatë marrjes së vendimit të ri, gjykata duhet të ketë parasysh kufizimet sipas nenit 395 të kodit aktual.’ Neni 395 të KPP deklaron kufizimin *Reformatio in Peius* dhe, derisa ky nen është i zbatueshëm vetëm sa i përket klasifikimit ligjor të veprës dhe sanksioneve të caktuara penale, neni 438 (2) është më i gjerë në fushën e veprimit dhe i referohet ' dëmit ndaj të pandehurit'. Nuk ka vendim më të favorshëm në rigjykimin e të pandehurve në këtë rast pasi të gjithë të pandehurit janë liruar nga të gjitha veprat penale. Prandaj, nuk ka asnjë qëllim për anulimin e aktgjykimit të ankimuar dhe kthimin e çështjes në Gjykatën themelore për rigjykim "- shih vendimin të cilit i referohet.

Interpretimi i prokurorisë nuk sqaron se si interpretimi i saj është në pajtim me dispozitat e neneve 440, paragrafi 3, dhe 436, paragrafi 3, KPP dhe madje edhe me nenin e 432, paragrafi 2, KPP, të gjitha në dëm të pandehurit.

Përveç kësaj, "paragrafi 2 i nenit 4 deklaron " vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit të dënuar, me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe' . Kolegji nuk është i mendimit se një përjashtim nga neni 4 (2) parashikohet në nenin 439, pasi që pastaj neni 438 (2) nuk do të kishte kuptim. Një përjashtim i tillë siç parashihet në nenin 4 (2) mund të gjendet vetëm në nenet 418 dhe 419 të KPP-së lidhur me rihapjen e procedurës penale "- idem.

Sa i përket argumentit të nenit 438, paragrafët 1 dhe 2, përbëjnë vetëm kërkesat (respektivisht) e parashtruara në dëm dhe në dobi të pandehurit, ku neni 439 përfshin të dyja, jo vetëm që nuk ka korrespondencë me tekstin aktual të ligjit, por gjithashtu shkon kundër interpretimit sistematik dhe teleologjik të grupit të normave që rregullojnë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, por gjithashtu, a do të ishte e nevojshme, parimi bazë i përcaktuar në nenin 3, paragrafi 2, KPP (i cili nuk bën dallim midis ligjit penal substancial ose procedural), ku thuhet "dyshimet lidhur me zbatimin e një dispozite të caktuar penale do të interpretohen në favor të të pandehurit (...)".

Së fundmi, sa i përket argumentit të prokurorisë se formulimi i përdorur në nenin 439 të KPP (ngritët dyshim i konsiderueshëm për saktësinë e përcaktimit faktik) është i ndryshëm në krahasim me atë të përdorur në dispozitat si p.sh. neni 432 paragrafi 2, dhe neni 437 (vërtetimi i gabuar ose jo saktë i gjendjes faktike), Gjykata supreme nuk gjen asnjë rast të mundshëm kur dyshimet në lidhje me saktësinë e përcaktimit faktik nuk kanë të bëjnë me vërtetimin e drejtë apo të gabuar, të plotë ose jo të plotë të gjendjes faktike. Çfarë do të kishte lidhje me saktësinë e përcaktimit faktik?

Sa i përket argumenteve të paraqitura nga prokurori i shteti lidhur me meritat sa i përket pikës 2 dhe 5 të këtij propozimi, neni 370 paragrafët 6

dhe 7 (*ex vi* neni 384, paragrafi 1.12) KPP, serish kolegji eshet i mendimit se kerkesa eshte e pabazuar.

Asgje ne ligj nuk e ndalon nje gjykatë me te larte te respektimit te arsyetimit te nje gjykate me te ulët duke e miratuar atë (gje qe eshte ndryshe nga mungesa e arsyeve) nese konsiderohet se nuk ka nevojë te shtohet arsyetimi nje vendimi te caktuar, ligji apo fakteve. Ndryshe nga pretendimet e prokurorisë, ne deklarimin e arsyeve, keto te fundit jane te pranishme per secilen pike individuale te aktgjykimit dhe kane deklaruar qarte faktet qe konsiderohen te vertetuara ose te pa provuara, si dhe arsyet per te tilla, se bashku me vleresimin e besueshmërisë se provave kundërthënëse.

Niveli i saktësisë apo detajeve eshte subjekt i diskrecionit, perderisa margjina eshte ende brenda kufijve te caktuar sipas ligjit per ta bere vendimin e kuptueshem (domethene, kerkesat ne fjale, sipas paragrafëve 6 dhe 7).

Sigurisht qe eshte gjithmonë e mundur te jete me i detajuar. Megjithese nuk eshte e nevojshme ne ketë pike per t'u angazhuar ne nje shtjellim te plotë, vlen te permendet dhe si shembull, kur prokuroria pohon se deklaratat e dëshmitarëve B. R., G. R., E. B. dhe Sh.H. nuk jane adresuar siç duhet, nuk eshte e vertete. Gjykata e apelit shqyrtoi ato por nuk gjeti asnje nevojë per persëritjen e shtjellimeve te bera ne to nga shkalla e pare. Eshte e vertete qe Gjykata e apelit ne faqen 42 i referohet paragrafëve 18 dhe 347 deri 355 lidhur me këta dëshmitarë, kur mund t'i ketë bere edhe te tjerët (per shembull, B.R., paragrafi 16 por gjithashtu 355, 462, G.R. 46 350, 447, 473 dhe 534, E. B., paragrafi 40 por edhe 464 dhe Sh.H., paragrafi 33, por gjithashtu 458, 462 dhe 464.

Sa i perket konceptit te "dëshmitarëve kryesorë", pa theksuar cili, eshte e qarte se sa i perket (kryesisht akuzës dy) kesaj, te gjitha ato jane analizuar ne detaje ne paragrafët 358 deri 480 te aktgjykimit te shkallës së pare (dhe per dëshmitarët X dhe Y , per shembull, nga paragrafët 482 deri 498), duke filluar nga Sh. A. dhe me pas nga bashkeshortja e tij, V.A., etj., si dëshmi nga dëshmitari, gjykata iu drejtua te gjithave. Duke pasur parasysh ketë, dhe te cekurat si me lart, se ka vend per diskrecion

kur bëhet fjalë për arsyetim, përderisa plotësohen kërkesat, si në këtë rast, kjo gjykatë konsideron se arsyet e lartpërmendura janë pa merita, pasi që është e qartë se themeli i kërkesave është mospajtimi i prokurorisë me vlerësimin e provave, siç theksoi edhe Gjykata e Apelit.

E njëjta vlen edhe për shkeljen e pretenduar të nenit 361 të KPP nga Gjykata e apelit.

Në fund, siç konsiderohet e rëndësishme për rastin në fjalë, për përpikërinë e arsyetimit, kolegji citon këtu Nenin për të drejtën për një gjykim të drejtë nga Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut (neni 6 i GJEDNJ). "Arsyetimi i vendimeve gjyqësore '- Sipas praktikave të përcaktuar gjyqësore që pasqyrojnë një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të tregojnë në mënyrë të duhur arsyet në të cilat ato bazohen (Papon V. Franca)

Vendimet e arsyetuara shërbejnë për t'i treguar palëve se janë dëgjuar, duke kontribuar kështu që ata me lehtë ta pranojnë vendimin. Pos kësaj, ata obligojnë gjykatësit që ta bazojnë arsyetimin e tyre në argumente objektive si dhe të mbrojnë të drejtat e mbrojtjes.

Megjithatë, shtrirja e detyrës për të dhënë arsyet ndryshon sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet sipas rrethanave të rastit (Ruiz Torija v. Spanjës, § 29). Përderisa gjykatat nuk janë të obliguara të japin një përgjigje të detajuar për çdo argument të ngritur (Van de Hurk v. Holandës, § 61), duhet të bëhet e qartë nga vendimi se janë adresuar çështjet thelbësore të rastit (shih Boldea v. Rumanisë, § 30). Gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat në të cilat bazojnë vendimin e tyre në mënyrë që të lejojnë palën ndërgjyqësore të përdorë çdo të drejtë të mundshëm për ankesë (Hadjianastassiou v. Greqisë dhe Boldea v. Rumanisë) [theksimi i shtuar] ".

Përfundim

Në bazë të lartcekurave është vendosur si në dispozitiv.

Gjyqtari kryesues

Procesmbajtëse

Gjyqtari i EULEX-it, Jorge Martins Ribeiro Vjollca Kroci-Gerxhaliu

Anëtarë të kolegjit

**Gjyqtarja e EULEX-it
Elka Filcheva-Ermenkova**

**Gjyqtarja e Gjykatës supreme
Nesrin Lushta**